



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

**Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Muaji KORRIK mbajtur sot me datë 28/07/2023
ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.**

Në mbledhje marrin pjesë 11 këshilltarë: Luljeta Dollani, Albert Ceci, Erald Carciu, Idri Kokla , Roland Mimini, Kujtim Brahimi, Marsela Ibro, Alfrida Shahini, Dalip Hazazaj, Arnilda Dakare.

Mbledhja drejtohet nga zv/Kryetari i Këshillit **znj. Arnilda Dakare.**

Në zbatim të **Nenit 192 të rregullores së Këshillit Bashkiak**;“ Kryetari i Bashkisë ka të drejtë të ftojë stafin e tij në mbledhjet e Këshillit , për të dhënë shpjegime juridike dhe ligjore për projekt vendimet e paraqitura nga ekzekutivi në mbledhjen e Këshillit ’’; asistuan në mbledhje disa prej drejtorëve dhe përgjegjesit e drejtorive përkatëse që dorëzuan projekt vendimet dhe relacionet.

A.Dakare: Duke qene se kurumi eshte plotesuar mbledhjen e deklaroj te hapur.Para se te vazhdojme me rendin e dites kemi disa pika qe do i propozoj te futen ne rend dite :

- 1- Per dhenien e mandatit keshilltarit ne radhe znj.Erisa Zogu
 - 2- Per dhenien e ndihmes ekonomike per muajin Maj
 - 3-Per dhenien e informacionit per masat e mara per periudhen e veres
 - 4-Per perballimin e shpenzimeve te varrimit te te ndjereve A.Zogu, R.Zogu,E.Zogu
 - 5- Per perballimin e shpenzimeve te varrimit te te ndjerit M.Zogu
- Jeni dakort te futen ne rend dite?

***Miratohet futja e materialeve te mesiperme ne rend dite me 11 Vota PRO**

Votojme Rendin e dites?

***Miratohet rendi i dites me 11 Vota PRO**

Sekretar i Këshillit
Xhulia Gjini

zv/Kryetar i Këshillit
Arnilda Dakare

Çështja 1

1- Për dhënien dhenien e mandatit keshilltarit ne radhe znj.Erisa Zogu

Në mbledhje marrin pjesë 11 këshilltarë: Luljeta Dollani, Albert Ceci, Erald Carciu, Idri Kokla , Roland Mimini,Kujtim Brahimi, Marsela Ibro,Alfrida Shahini, Dalip Hazazaj, Arnilda Dakare.

A.Dakare: Mbas ardhjes se vakances pas doreheqjes se keshilltarit z.S.Dedja, kemi kandidatin ne radhe znj.Erisa Zogu, kalojme ne votim marrjen e mandatit te keshilltarit ne radhe?

***Miratohet pika e 1 e rendit të ditës me 11 Vota PRO**

Lexohet betimi nga zv/kryetarja , dhe betohet keshilltarja ne radhe E.Zogu

- **Ne Mbledhje marrin pjese 12 keshilltare.**
(Mbasi ben betimin znj.Erisa Zogu)

***(Vjen ne mbledhje z.F.Cekrezi, Ne mbledhje marrin pjese 13 Keshilltare.)**

Sekretar i Këshillit
Xhulia Gjini

zv/Kryetar i Këshillit
Arnilda Dakare

Çështja 2

- 2- Për përballimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerës Shpresa Besnik Bardhi.
 - 3- Për përballimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Elson Elmas Plaka.
 - 4- Për përballimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerës Sherife Shahin Daja.
 - 5- Për përballimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Fation Mustafa Bici.
 - 6- Per perballimin e shpenzimeve te varrimit te te ndjereve A.Zogu, R.Zogu,E.Zogu
 - 7- Per perballimin e shpenzimeve te varrimit te te ndjerit M.Zogu
- (Duke qene se keto materiale vijne nga e njejta drejtori relatohen rresht njera pas tjetres)

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Luljeta Dollani, Albert Ceci, Erald Carciu, Idri Kokla , Roland Mimini,Kujtim Brahimi, Marsela Ibro,Alfrida Shahini, Dalip Hazazaj, Arnilda Dakare,Erisa Zogu,Fatbardh Cekrezi.

Pergj.Emergj.Civile: Te gjitha materialet jane paraqitur me dokumentacion plotesues te cilat ju i keni pare.

Fillon lexon njera pas tjetres te gjithja materialet e paraqitura.

K.Brahimi: Te shpenzimet e varrimit kush futen? A futen shpenzimet e ushqimit si dreka? Apo vetem ato te shoqerise funerale?

Pergj.Emergj.Civile: Futen vetem shpenzimet e shoqerise se varrimit

A.Ceci: Kerkesa ka shume a beni ndonjehere verifikime?

Pergj.Emergj.Civile: po, ne i japim perparesi gjithmone familjeve qe i plotesojne kriteret .

A.Ceci: Per disa eshte ndryshe shuma e ofruar dhe per te tjere ndryshe.

Pergj.Emergj.Civile: Lidhur me personat qe u mbyten , per shkak te tragjedise qe ndodhi ne menduam qe te kompesohen te gjitha shpenzimet , per pjesen tjeter kemi caktuar shumen 50000 leke.

E.Carcu: Heres tjeter duhet te sillni cdo fature ose dokument qe i verteton keto me siper

A.Ceci: Te ndihmohen vertet familje qe nuk munden te perballojne ato shpenzime.

R.Mimini: Pjesa e abuzimit me faturat , ku shenohen shpenzime te paqena , pres te mos abuzohet me faturat.

Dr.Ekonomik: Ne i kemi diskutuar keto materiale lidhur me shpenzimet e varrimit , apo shpenzime per kurim te cilat realisht jane te tepruara. Ne kemi nje fond 2 mln leke te reja dhe deri me tani fondi eshte ne limitet e veta.

D.Hazizi : Duhet bere vertet per familje qe skane asnje njeri qe tu beje shpenzimet e varrimit.

K.Brahimi: Eshte nje firme private qe mer leke nga shteti, tender, nuk eshte e drejte qe kjo firme te marre leke per kompesim , por edhe shpenzime qe behen nga te tjere te kompesohen. Pra kesaj firme ti jepet mundesia te shtojte edhe kete shpenzim qe nuk kompesohet (flet per ushqimin).

A,Dakare: Keni pyetje te tjera?

L.Dollani: Jam dakort me diskutimin qe u be, doja te pyesja a ka raste e tjera?

Pergj.Emergj.Civile: Po ka raste te tjera.

A.Dakare: Vazhdojme?

F.Cekrezi: Funkdioni i komisioneve e ben efektv vendimarrjen tone, cdo material duhet te kete dokumentacion plotesues.

A.Dakare:Kalojme ne votim materialet si me poshte?

- 1- Për përballimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerës Shpresa Besnik Bardhi.
 - **Miratohet me 13 vota pro.**
- 2- Për përballimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Elson Elmas Plaka.
 - **Miratohet me 13 vota pro.**
- 3- Për përballimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerës Sherife Shahin Daja.
 - **Miratohet me 13 vota pro.**
- 4- Për përballimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Fation Mustafa Bici.
 - **Miratohet me 13 vota pro.**
- 5- Per perballimin e shpenzimeve te varrimit te te ndjereve A.Zogu, R.Zogu,E.Zogu
 - **Miratohet me 13 vota pro.**
- 6- Per perballimin e shpenzimeve te varrimit te te ndjerit M.Zogu
 - **Miratohet me 13 vota pro.**

Sekretar i Këshillit
Xhulia Gjini

zv/Kryetar i Këshillit
Arnilda Dakare

Çështja 3

3- Për miratimin e ndihmes ekonomike pëwr muajin Maj (fondi 6%)

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Luljeta Dollani, Albert Ceci, Erald Carciu, Idri Kokla , Roland Mimini, Kujtim Brahimi, Marsela Ibro, Alfrida Shahini, Dalip Hazazaj, Arnilda Dakare, Erisa Zogu, Fatbardh Cekrezi.

A.Dakare: Per vijimesi vazhdojme me ndihmen ekonomike, nese keni pyetje?

Pergj. ndih. ek: Per muajin Qershor jane 35 familje perfituese , ashtu si cdo muaj materialin e keni ne dipozicion, keni pyetje?

E. Carciu: Kerkoj info si funksionon perzgjedhja e familjeve per ndihmen ekonomike.

Sqaron pergjegjesja e ketij sektori te gjith proceduren e aplikimit dhe perfitimit.

A.Dakare: Kalojme ne votim?

***Miratohet me 13 Vota PRO**

Sekretar i Këshillit

Xhulia Gjini

zv/Kryetar i Këshillit

Arnilda Dakare

Çështja 4


4- Të tjera, Kërkesa nga Qytetarët.

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Luljeta Dollani, Albert Ceci, Erald Carciu, Idri Kokla , Roland Mimini, Kujtim Brahimi, Marsela Ibro, Alfrida Shahini, Dalip Hazazaj, Arnilda Dakare, Erisa Zogu, Fatbardh Cekrezi.

A. Dakare: Flitet për kërkesat e qytetarëve, Laert Shyqyriu i cili është aksidentuar në krye të detyrës (zjarrefikes) i cili është djegur në të dy krahet dhe ka pasur probleme të rënda shëndetsore ka paraqitur një kërkesë për tu ndihmuar për të përballuar sadopak shpenzimet e kurimit .

F. Cekrezi: Është marrë një vendim për të njëjtin person dhe për të njëjten çështje , duhet vetëm të çojnë dokumentat shtese.


Sekretar i Këshillit
Xhulia Gjini



zv/Kryetar i Këshillit
Arnilda Dakare



Adresa: Sheshi "Kamber Dermysi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com



Çështja 5

5- Për dhenien e informacionit mbi masat e marra gjate stines se veres

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Luljeta Dollani, Albert Ceci, Erald Carciu, Idri Kokla , Roland Mimini, Kujtim Brahimi, Marsela Ibro, Alfrida Shahini, Dalip Hazazaj, Arnilda Dakare, Erisa Zogu, Fatbardh Cekrezi.

Shefi i Zjarrefikeses: Ju eshte paraqitur nje informacion nese keni pyetje jemi te hapur tu pergjigjemi.

F.Cekrezi: Nisur nga tragjedia qe ndodhi a eshte e nevojshme a eshte e nevojshme nje mjet lundrues qe te jete ne gatishmeri prane liqenit?

Ne raport me kohen sa eshe numri i zjarrevenieve te qellimshme apo jo?

Shefi i Zjarrefikeses: Po e nis nga e fundit, kjo i perket policise lidhur me ndjekjen penale per ata qe bejne zjarrenie te qellimshme, lidhur me mjetin lundrues ne kemi mjet lundrues dalim shpesh dhe jemi ne trajnim e siper. Eshte e pamundur te kontrollohet gjithe siperfaqja e liqenit por jemi aty cdo dite per ndihma emergjente.

E.Carciu: Bashkia ti drejtrohet me shkrese Devoll Hidropower qe ti mbeshtesin financiarisht familjet e demtuara nga tragjedia, pasi nuk kane vene asnje table informuese.

Shefi i Zjarrefikeses: I kam paraqitur njen shkrese ish-kryetarit edhe per kanionin e holtes , te vendoset roje te jepn kasketa mbrojtese atyre qe futen ne kanion.

A.Ceci: Mesa di eshte duke u bere ky projekt nga kryetari i ri.

Sekretar i Këshillit
Xhulia Gjini

zv/Kryetar i Këshillit
Arnilda Dakare

Çështja 6

6- Për një shtesë orari në linjën e transportit rrethqytetës Gramsh-Vidhan dhe anasjelltas.

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Luljeta Dollani, Albert Ceci, Erald Carciu, Idri Kokla , Roland Mimini, Kujtim Brahimi, Marsela Ibro, Alfrida Shahini, Dalip Hazazaj, Arnilda Dakare, Erisa Zogu, Fatbardh Cekrezi.

Pergj. Emergj. civile: Eshte bere nje kerkese per shtese orari per linjen Gramsh-Vidhan dhe anasjelltas , pra i njeiti person te kete shtese orari. Ka pasur nje kerkese nga komuniteti dhe personi qe ka linjen ka paraqitur kerkese.

L. Dollani: Aq njerez jane cudi si kerkohet shtese orari.

Pergj. Emergj. civile: Vetem ky eshte operator i kesaj linje.

L. Dollani: Nuk duhet te krijojme konflikte , beni nje studim te mos krijoni konflikte me linjen tjeter.

A. Ceci: Nese ka kerkese nga komuniteti duhet te kete nje shkrese e bere nga banoret qe te na vihet ne dijeni.

E. Carciu: Me mire te kete shtese orari

A. Ceci: Me mire te plotesohet dokumentacioni, te sqarohet edhe linja tjeter per mos perplasje orari.

A. Dakare: Pra , vendoset shtyrja e kesaj pike.

Sekretar i Këshillit

Xhulia Gjini

zv/Kryetar i Këshillit

Arnilda Dakare

Çështja 7

7- Për ngritjen e Komisioneve për zgjedhjen e Kryesisë së Fshatrave.

Në mbledhje marrin pjesë 13 këshilltarë: Luljeta Dollani, Albert Ceci, Erald Carciu, Idri Kokla , Roland Mimini, Kujtim Brahimi, Marsela Ibro, Alfrida Shahini, Dalip Hazazaj, Arnilda Dakare, Erisa Zogu, Fatbardh Cekrezi.

**A. Ceci Ne po vazhdojme me Propozimet tona, jepni edhe ju sygjerimet tuaja.
(Me poshte grupet e sygjeruar ane bashkedakortesi nga keshilltaret)**

1- Pishaj Alfrida Shahini
Roland Mimini
Fatbardh Cekrezi
Erisa Zogu
Erald Carciu
Edmond Guri

2- Kodvjat Kujtim Brahimi
Valbona Verushi
Ardiana Hasa
Kodhel Cala

3- Kukur Marsela Ibro
Idri Kokla
Ramazan Braho
Edmond Guri

4- Kushovë Enis Zani
Ramazan Braho

5- Lenie Visarion Bici
Fatbardh Cekrezi

6- Porocan Luljeta Dollani
Erald Carciu

7- Skenderegas

Arnilda Dakare
Dalip Hazizaj
Ramazan Braho
Edmond Guri

8- Sult

Marsela Ibro
Kodhel Cala


9- Tunje


Albert Ceci
Greta Lena
Fatbardh Cekrezi
Erald Carciu

A.Dakare: Votojme?

***Miratohet me 13 Vota PRO**

**Sekretar i Këshillit
Xhulia Gjini**



Erald Carciu


**zv/Kryetar i Këshillit
Arnilda Dakare**

